

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E VLERËSIMIT

Nr. 4742/2 Prot.

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 22 . 09 . 2021

**LËNDA:** Dërgohet informacion në lidhje me aplikimet me formularët A1/A1Z

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**


**TIRANË**

Në kuadër të Maturës Shtetërore 2021, lutemi gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese urdhrin e QSHA nr. 80., datë 22.09.2021, "Për miratimin e periudhës së aplikimeve me formularët A1/A1Z për MSH 2021", në datat 27 deri më 29 shtator 2021. Vëmë në dijeni se njoftimi do të publikohet në faqen e internetit të QSHA.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**REZANA VRAPI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 742 Prot.

Tiranë, më 22. 09. 2021

**URDHËR**

Nr. 80, Datë 22.09.2021

PËR

**MIRATIMIN E PERIUdhËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARËT A1/A1Z PËR MSH  
2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.364, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

**U R D H Ë R O J:**

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularët A1/A1Z, për MSH 2021, **në datat 27 deri më 29 shtator 2021.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rezana VRAPI

DREJTORI PËRGJITHSHËM



Web site: [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al)

E-mail: [rezana.vrapi@qsha.gov.al](mailto:rezana.vrapi@qsha.gov.al)